



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.3/20

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike të paditësit S. K. nga Vushtrria rr.M.Xh. nr.11, të cilin e përfaqëson av.Shqipe Mehmeti nga Mitrovica, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e pagave për shpërblim jubilar, vlera e kontestit 1800 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, verbal e publik, të mbajtur në seancën e datës 16.11.2020, në të njëjtën ditë, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. REFUZOHET** padia dhe kërkesëpadija e paditësit S. K. nga Vushtrria rr.M. Xh. nr., kundër të paditurës Koorporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e pagave për shpërblim jubilar, vlera e kontestit 1800 euro, **si e pa bazuar**.

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

### A r s y e t i m

Paditësi me datën 06.01.2020, në këtë gjykatë ka paraqitur padi dhe kërkesëpadi, kundër të paditurës Koorporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, për kompensimin e pagave për shpërblim jubilar me pretendimin se në bazë të Kontratës së Përgjithshme të Kolektive të Kosovës i takojnë tri paga për shpërblim jubilar në shumën prej 1881 euro, të precizuara në seancë në shumën prej 1800 euro, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e tij ta miratojë në tërësi si të bazuar, duke kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata ka caktuar seancën gjyqësore me datën 16.11.2020 në të cilën morën pjesë përfaqësuesja e paditësit Shqipe Mehmeti nga Mitrovica, paditësi personalisht dhe përfaqësuesi i të paditurës Arsim Shaljani.

Përfaqësuesi i paditësit av.Shqipe Mehmeti gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar në këtë gjykatë, duke i propozuar gjykatës që në emër të tri pagave për shpërblim jubilar të detyrohet e padituara të ia paguaj shumën prej 1800 euro. Shpenzimet i kerkoi dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 euro, për përfaqësim në seancë 130 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30 euro.

E paditura përmes të autorizuarit të saj Arsim Shaljani gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka skaduar me datën 31.12.2017 pasi që Oda ekonomike e Kosovës është tërhequr nga kjo marrëveshje kolektive E ka konstestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar me arsyetimin se paditësi nuk i ka përmbushur kushtin për shpërblim jubilar.

Me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave bëri leximin dhe administrimin e provave si: Kontratën e punës në emër të palëve ndërgjyqëse të datës 01.03.2018, Kartelen e punëtorit të datës 06.01.2020, vendimin e të paditues të datës 18.11.2019, pasqyren bankare të lëshuar nga Raiffeisen Bank në emër të paditësit, përgjigjen në padi të të paditues të datës 11.11.2020.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ka qenë i punësuar pranë të paditues në Prodhimi TCA divizionin Termocentrali Kosova – A, në cilësinë e manipulant i mullinjëve (Px), - A4/8, që nga viti 1980 e gjerë në pesnion dhe se paditësi kishte më tepër se 30 vite përvojë pune tek e paditura.

Mirëpo gjykata gjeti se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës që ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015, ka skaduar në fund të vitit 2017 respektivisht me datën 31.12.2017 dhe nga data 01.01.2018, kjo kontratë nuk është më në fuqi dhe nuk ka efekt detyrues ndaj të paditurës, sepse Oda Ekonomike e Kosovës, si palë në këtë kontratë, është tërheq nga zbatimi i kësaj kontrate me datën 13.11.2017, kur edhe është publikuar njoftimi i tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e duke u bazuar në nenin 81 par.1, të kësaj kontrate.

Nga këto arsye Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka efekt retroaktiv, detyrues juridik, për kompensimin e tri pagave për shpërblim jubilar ndaj paditësit.

Duke marrë parasysh se paditësi me datën 06.01.2020 pranë kësaj gjykate ka paraqitë padinë dhe kërkesëpadinë e tij, ndërsa Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme nga data 01.01.2018 e tutje, e mbi bazën e të lartcekurave, gjykata e refuzoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Në bazë të nenit 90 par. 4 te Ligjit nr. 03/L-212 te Punës, marrëveshjet e tilla kolektive, lidhen për një periudhë të caktuar në kohëzgjatje jo më shumë se tri vite, andaj afati i rregullt ligjor kontratës së tillë i ka skaduar me datën 31.12.2017, meqenëse njëra nga palët nënshkruese të kësaj kontrate dhe atë Oda Ekonomike e Kosoves është tërhequr nga kjo Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive.

Duke marrë parasysh se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive i ka skaduar afati i zbatimit, gjykata gjen se paditësit nuk i takon e drejta në tri paga të shpërblimit, ndërsa e paditura nuk ka marrëveshje të tjera kolektive të cilat të punësuarve të tyre do të ua njohje këtë drejtë.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 450 të Ligjit për Procedurës Kontestimore.

Nga sa u tha më lart e në bazë të nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

**Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil**

**C.nr.03/20, datë: 16.11.2019**

**GJYQTARI**

**Izet Gërguri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, përmes kësaj gjykate Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.